

**ANNA ENERGIA sh. p. k.**

**Pasqyrat Financiare Individuale  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**



Emërtimi dhe forma ligjore: **ANNA ENERGIA SH.P.K.**  
NIPT (NUIS): **L01720023L**  
Adresa e selisë: **RR "NIKOLLA TUPE", Nd. 7, H 3, Ap. 1**  
Data e krijimit: **20.05.2010**  
Veprimtaria kryesore: Prodhimi, transmetimi, shitja dhe tregtimi i energjisë elektrike të prodhuar si dhe financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, menaxhimi dhe mirëmbajtja e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike.

**PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE  
PËR VITIN E MBYLLYR MË 31 DHJETOR 2015**

Pasqyrat Financiare janë individuale:	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara:	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në:	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në:	Lekë
Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare:	Nga 01.01.2015 deri më 31.12.2015
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare:	10.03.2016

 1

## Përmbajtja:

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015	3
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	6
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	7 - 15

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Pasqyra e pozicionit financiar

më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek)


	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Aktivitet</b>			
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	5,234,405	6,309,655
Të drejta të arkëtueshme	5	1,639,652	1,364,412
Shpenzime të shtyra		-	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>6,874,057</b>	<b>7,674,067</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara	2.1, 6	304,107,157	288,003,945
Investime në shoqëri të kontrolluara	2.1, 7	264,512,500	264,512,500
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>568,619,657</b>	<b>552,516,445</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>575,493,714</b>	<b>560,190,512</b>
<b>Detyrime dhe kapitali</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime afatshkurtra	8	3,362,745	4,243,043
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>3,362,745</b>	<b>4,243,043</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime afatgjata	9	232,356,559	210,948,005
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>232,356,559</b>	<b>210,948,005</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>235,719,304</b>	<b>215,191,048</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i nënshkruar	1	401,580,340	401,580,340
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		(56,580,876)	(44,244,242)
Fitimi (humbja) e vitit		(5,225,054)	(12,336,634)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>339,774,410</b>	<b>344,999,464</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>575,493,714</b>	<b>560,190,512</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 u aprovuan nga Bordi Drejtues i Anna Energia sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 10 mars 2016.

  
Attilio Bressan  
Administrator



  
Brunila Leskaj  
Kontabël i Miratuar  
HM&H Business Sh.p.k.



# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:</b>		
Të ardhurat nga shitja	-	-
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	-	-
<b>Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzimet:</b>		
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-	-
Shpenzime të personelit:	10	
Paga dhe shpërblime	(185,520)	(960,000)
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	(160,320)	(160,320)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Amortizimi dhe shpenzime konsumi	-	-
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	11	
	(3,291,149)	(11,067,407)
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>(3,636,989)</b>	<b>(12,187,727)</b>
<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Të ardhurat dhe shpenzime financiare:</b>		
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto	12	
	3,451	3,419
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	13	
	(1,591,516)	(152,326)
<b>Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>	<b>(1,588,065)</b>	<b>(148,907)</b>
<b>Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>	<b>(5,225,054)</b>	<b>(12,336,634)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14	
	-	-
<b>Fitimi (humbja) e vitit</b>	<b>(5,225,054)</b>	<b>(12,336,634)</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</b>		
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje	-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>(5,225,054)</b>	<b>(12,336,634)</b>

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në qet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

 4

## ANNA ENERGIA sh. p. k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet (humbjet) e pashpërndara	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2014</b>	<b>359,565,340</b>	<b>(44,244,242)</b>	<b>315,321,098</b>
<b>Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:</b>			
Fitimi (humbja) e vitit	-	(12,336,634)	(12,336,634)
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(12,336,634)</b>	<b>(12,336,634)</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	42,015,000	-	42,015,000
Dividendë të paguar	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>42,015,000</b>	<b>-</b>	<b>42,015,000</b>
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2014</b>	<b>401,580,340</b>	<b>(56,580,876)</b>	<b>344,999,464</b>
<b>Pozicioni më 1 janar 2015</b>	<b>401,580,340</b>	<b>(56,580,876)</b>	<b>344,999,464</b>
<b>Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:</b>			
Fitimi (humbja) e vitit	-	(5,225,054)	(5,225,054)
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(5,225,054)</b>	<b>(5,225,054)</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2015</b>	<b>401,580,340</b>	<b>(61,805,930)</b>	<b>339,774,410</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
<b>Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit:</b>		
Fitimi (humbja) e vitit	(5,225,054)	(12,336,634)
Rregullime për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	1,604,795	-
Rimarrje (krijim) i provizioneve	332,461	46,341
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie (Rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(634,901)	2,267,426
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	(857,205)	(332,562)
Rritje (rënie) në detyrimet për punonjësit	-	774,480
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>(4,779,904)</b>	<b>(9,580,949)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit:</b>		
Pagesa për huatë dhënë shoqërive të kontrolluara	(22,171,300)	(42,539,433)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit</b>	<b>(22,171,300)</b>	<b>(42,539,433)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit:</b>		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit	-	42,015,000
Arkëtime nga financimet e ortakëve	25,956,233	14,927,427
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit</b>	<b>25,956,233</b>	<b>56,942,427</b>
<b>Rritje (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(994,971)</b>	<b>4,822,045</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>6,309,655</b>	<b>1,487,610</b>
<i>Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(80,279)	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 5,234,405</b>	<b>6,309,655</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7–15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Anna Energia sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ("QKR") nr. CN-397144-05-10, më 20 maj 2010.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston në prodhimin, transmetimin, shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar si dhe financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike.

Kapitali i nënshkruar i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 është 401,580,340 Lek (31 dhjetor 2014: 401,580,340 Lek). Veprimet me kapitalin gjatë vitit 2014 konsistojnë në sa më poshtë:

- Ndryshimi i emrit të ortakut "Folla di Bressan Lucia & C" në "Folla di Satin Fabio & C.S.a.s". Pjesëmarrja mbetet e pandryshuar në 15.11% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë kontributi prej 15,165,867 Lekë.
- Largim i ortakut Silvio Arrivabene si rezultat i shitjes së kuotës me pjesëmarrje prej 2.28% dhe vlerë 9,142,161.90 Lekë për ortakun e ri Luisa Bressan sipas kontratës për shitjen e kuotave datë 15.06.2015.

Si rrjedhojë e veprimeve të mësipërme me kapitalin, struktura e Ortakëve të Shoqërisë si dhe gjendja e kapitalit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Ortakut	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%
Lumiei Impianti	75,829,335	18.88%	75,829,335	18.88%
Immobiliare Luisa	136,492,803	33.99%	136,492,803	33.99%
Luisa Bressan	9,142,162	2.28%	-	0.00%
Silvio Arrivabene	-	0.00%	9,142,162	2.28%
Attilio Bressan	60,663,468	15.11%	60,663,468	15.11%
Folla di Satin Fabio & C.S.a.s.*	15,165,867	3.78%	15,165,867	3.78%
Finest SPA	98,263,000	24.47%	98,263,000	24.47%
Eriberto Bressan	2,007,902	0.50%	2,007,902	0.50%
Renato Bressan	2,007,902	0.50%	2,007,902	0.50%
Enzo Bressan	2,007,902	0.50%	2,007,902	0.50%
<b>Totali</b>	<b>401,580,341</b>	<b>100.00%</b>	<b>401,580,341</b>	<b>100.00%</b>

\* ish Folla di Bressan Lucia & C

	Kapitali i nënshkruar	Kapitali i nënshkruar i papaguar	Totali i kapitalit të nënshkruar të paguar
Kapitali i nënshkruar më 1 janar 2014	359,565,340	-	359,565,340
Emetim i kapitalit	42,015,000	-	42,015,000
Pagesa të kapitalit të papaguar	-	-	-
Kapitali i nënshkruar më 1 janar 2015	401,580,340	-	401,580,340
Emetim i kapitalit	-	-	-
Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2015	401,580,340	-	401,580,340

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Attilio Bressan i cili është dhe administrator i emëruar i Shoqërisë.

NIPT-i i Shoqërisë është L01720023L dhe adresa kryesore e saj është në: Rruga Nikolla Tupe, Nd.7, H. 3, Ap.1, Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 është 1 (31 dhjetor 2014 : 1).



# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK), të cilat janë të aplikueshme në mënyre prospektive duke filluar nga data 1 janar 2015.

##### Riklasifikimet

Vlerat në pasqyrat financiare krahasuese janë riklasifikuar për të siguruar përputhshmërinë me paraqitjen e pasqyrave financiare për periudhën e raportimit.

Riklasifikimet të tjera në pasqyrat krahasuese përfshijnë riklasifikimin e vlerës së kontributit shtesë prej 229,500,000 Lek në shoqëritë e kontrolluara të Shoqërisë nga "Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara" tek "Investime në shoqëri të kontrolluara" (shih shënimet 6 dhe 7). Riklasifikimi nuk ka efekte në periudha më të hershme se periudha krahasuese apo efekte të tjera materiale të cilat kërkojnë rregullime.

<b>Paqyra e pozicionit financiar (ekstrakt)</b>	<b>31 dhjetor 2014 (fillestare)</b>	<b>Riklasifikime</b>	<b>31 dhjetor 2014 (riklasifikuar)</b>
Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara	517,503,945	(229,500,000)	288,003,945
Investime në shoqëri të kontrolluara	35,012,500	229,500,000	264,512,500
<b>Totali</b>	<b>552,516,445</b>	<b>-</b>	<b>552,516,445</b>

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim janë përshkruar në detaje në shënimet shpjeguese në vijim.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Zërat jomonetare të cilat përlogariten me kosto historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksionit fillestar. Zërat jomonetare të cilat njihen me vlerën e drejtë, në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Humbja ose fitimi që rezulton nga konvertimi i zërave jomonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të zërave të pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. diferencat e konvertimit në zëra të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e performancës).

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
1 EUR	137.28	140.14

### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat si dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim origjinal tre ose më pak muaj, të cilat janë objekt rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve të saj afatshkurtra.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.



# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen me blerjen e aktivitetit si dhe kosto të tjera direkte që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në koston e aktivitetit nuk përfshihen kostot e huamarrjes të cilat njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në të ardhura të tjera në pasqyrën e performancës.

#### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual të periudhës si dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në pasqyrë e performancës përveç rasteve kur këto lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Kompensimi midis aktiveve tatimore aktuale dhe detyrimeve tatimore aktuale ose midis aktiveve tatimore të shtyra dhe detyrimeve tatimore të shtyra kryhet vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar këto shuma ose kur do të paguhet shuma neto e tyre apo do të realizohen aktivet dhe do të shlyhen detyrimet në të njëjtën kohë.

#### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual është përlllogaritjen e tatimit mbi fitimin të pagueshëm në lidhje me fitimin e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e raportimit si dhe sistemimet në lidhje me tatimin e pagueshëm për periudha të shkuara.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore përlllogaritjen në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'u paguhet autoriteteve tatimore. Për llogaritjen e vlerave u bëhet referencë normës tatimore dhe legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë në datën e raportimit. Fitimi i tatueshëm i periudhës ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën e performancës si pasojë e rregullimeve në zërat e ardhurave ose shpenzimeve të cilat janë tatuar apo njohur si të zbritshme në periudha të tjera si dhe zërave të cilët nuk janë të tatueshëm apo të zbritshëm bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi.

Drejtimi i shoqërisë në mënyrë periodike vlerëson qëndrimet e mbajtura në përgatitjen e deklaratave tatimore për ato raste në të cilat parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi janë subjekt i interpretimeve nga ana e organeve tatimore shqiptare dhe krijon provizione aty ku është e përshtatshme.

#### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivitet tatimore të shtyra me fitimin e tatueshëm të viteve të ardhshme.

Aktivitet apo detyrimi tatimor i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme të lidhura me:

- njohjen e emrit të mirë;
- fitimet e papaguara nga investimet në filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është i përhershëm i në kohëzgjatje përveçse kur është e dukshme që e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra përlllogaritjen sipas normës tatimore në fuqi në datën e raportimit.

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse:		
Në Lek	313,381	352,091
Në Euro	4,921,024	5,957,564
<b>TOTALI</b>	<b>5,234,405</b>	<b>6,309,655</b>

### 5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
TVSH e arkëtueshme	172,998	172,998
Paradhënie për furnitorë	1,128,873	1,129,754
Paradhënie për tatimin mbi fitimin	336,120	60,000
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	1,659	1,660
<b>TOTALI</b>	<b>1,639,650</b>	<b>1,364,412</b>

Në vitin 2014, vlera e TVSH-së së arkëtueshme u ul ndjeshëm si rezultat i vlerësimit tatimor bërë nga administrata tatimore nëpërmjet Njoftim Vlerësimi Tatimor nr. 43143.4 datë 05.11.2014 sipas së cilit vlera e TVSH-së kreditore të Shoqërisë për periudhat 2010, 2011, 2012 dhe deri më gusht 2013 në një vlerë prej 2,183,048 Lek nuk është njohur nga ana e autoritetit në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi.

### 6. Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara

Të arkëtueshmet nga shoqëritë e kontrolluara më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 në vlerat 304,107,157 Lek dhe 288,003,945 Lek, përkatësisht konsistojnë në financime dhënë shoqërisë së kontrolluar HEC Vluse sh.p.k. për rritje të ardhshme kapitali. Për këto financime nuk llogaritet interes. Vlera e financimeve në monedhën origjinale më 31 dhjetor 2015 është 2,215,233Euro (31 dhjetor 2014: 2,055,116 Euro). Vlera e të arkëtueshmeve më 31 dhjetor 2015 është rivlerësuar me kursin e këmbimit publikuar nga Banka e Shqipërisë prej 137.28 Lek/Euro (2014: 140.14 Lek/Euro).

Më 22 dhjetor 2014, një pjesë e financimeve dhënë shoqërisë të kontrolluar, në vlerën 229,500,000 Lek, u vendos të kalohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë së kontrolluar bazuar në Vendimin nr. 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë HEC Vluse sh.p.k. (shih shënimin 7).

### 7. Investime në filiale

Investimet në shoqëri të kontrolluara përfshijnë investimet e mbajtura në kosto në shoqërinë HEC VLUSHE sh.p.k..

Vlera e investimeve në shoqëri të kontrolluara më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përkatësisht në vlerën 264,512,500 Lek konsiston në:

- Çmimin prej 35,012,500 Lek paguar për blerjen e 51% të kapitalit të kësaj shoqërie sipas kontratës për shitblerjen e kuotave datë 30.09.2011 dhe shtesës së kontratës për shitblerjen e kuotave datë 29.02.2012. Data efektive e transferimit të kuotave është data 28.02.2012 në vijim të miratimit për transferimin e kuotave nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës nëpërmjet miratimit datë 27.02.2012 nr. prot. 5244/1.
- Vlerën e kontributit shtesë prej 229,500,000 Lek si rrjedhojë e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë HEC Vluse sh.p.k. bazuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 2 datë 22 dhjetor 2014. Pjesëmarrja e Shoqërisë pas zmadhimit të kapitalit mbetet e pandryshuar në 51% të vlerës së kapitalit. Vlera e kontributit shtesë u kontribua nga pjesë e financimeve dhënë filialit për rritje të ardhshme kapitali (shih shënimin 6).

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 8. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paradhënie nga ortakët për shpenzime operacionale	1,106,614	1,129,564
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	120,127	930,991
Të pagueshme ndaj punonjësve	2,098,320	2,098,320
Të pagueshme për sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	22,320	22,320
Të pagueshme për detyrime tatimore	-	46,341
Të tjera të pagueshme	15,364	15,507
<b>TOTALI</b>	<b>3,362,745</b>	<b>4,243,043</b>

### 9. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2015 në vlerë 232,356,559 Lekë dhe 2014 në vlerë 210,948,005 Lekë konsistojnë në paradhënie nga ortakët për financimin e veprimtarive operacionale dhe investuese të Shoqërisë. Vlera e detyrimeve në monedhën origjinale më 31 dhjetor 2015 është 1,692,574 Euro (2014: 1,505,266) dhe për këto financime nuk llogaritet interes.

### 10. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përbëhet nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Paga dhe shpërblime	185,520	960,000
Shpenzime të sigurime shoqërore dhe shëndetësore	160,320	160,320
<b>TOTALI</b>	<b>345,840</b>	<b>1,120,320</b>

### 11. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime përkthimi	-	47,842
Shpenzime për detyrime tatimore, gjoba dhe interesa	40,000	3,917,575
Shpenzime për shërbime konsulence profesionale	3,373,325	3,977,460
Shpenzime për konsulence teknike	-	2,618,366
Krijim (rimarrje) i provizione për detyrime tatimore	(332,461)	322,461
Komisionet dhe shërbimet bankare	109,365	89,152
Shpenzime noteriale	15,600	8,880
Taksa dhe tarifa vendore	85,120	85,120
Shpenzime të ndryshme zyre	200	550
<b>TOTALI</b>	<b>3,291,149</b>	<b>11,067,407</b>

### 12. Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga interesat dhe të ngjashme, neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesi nga llogaritë rrjedhëse me bankat	3,451	3,419
<b>TOTALI</b>	<b>3,451</b>	<b>3,419</b>



# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 13. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit, neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	16,948	4,222
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	4,571,560	77,707
	<b>4,588,508</b>	<b>81,929</b>
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(3,669)	(19,583)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(6,176,355)	(214,672)
	<b>(6,180,024)</b>	<b>(234,255)</b>
<b>TOTALI</b>	<b>(1,591,516)</b>	<b>(152,326)</b>

### 14. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2015 (2014: 15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

(i) *Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual*

Për vitet 2015 dhe 2014 Shoqëria ka rezultuar me humbje kontabël dhe me humbje tatimore si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Humbja fiskale e periudhës (përfundon në 2019)	3,335,594	2,952,376
Humbje të mbartura:		
Humbje e mbartur nga viti 2014 (përfundon në 2018)	2,952,376	-
<b>TOTALI</b>	<b>6,287,970</b>	<b>2,952,376</b>

Bazuar në legjislacionin tatimor shqiptar, Shoqëria ka të drejtë të mbartë humbjet tatimore për një periudhë tre vjeçare. Në rast se gjatë një periudhe pronësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e kapitalit të shoqërisë apo të drejtave të votës ndryshon me më shumë se 50%, atëherë e drejta e mbartjes së humbjeve të realizuara nga shoqëria në periudhën tatimore kur ndodh ndryshimi si dhe në periudhat paraardhëse nuk zbatohet.

Duke qenë se gjatë vitit 2013 struktura dhe rrjedhimisht pjesëmarrja e ortakëve të Shoqërisë ka ndryshuar me më shumë se 50% atëherë kjo e fundit nuk ka kryer mbartjen e humbjeve tatimore realizuar gjatë vitit 2013 si dhe të humbjeve realizuar në periudhat paraardhëse. Për këtë qëllim humbjet tatimore të mbartura të Shoqërisë më 1 janar 2014 janë 0 (zero) Lek.

Humbja tatimore e përlogaritur nga ana e Shoqërisë për vitin 2015 është 3,335,594 Lek (2014: 2,952,376 Lek).

*Rikoncilimi i normës efektive të tatimit:*

	2015	%	2014	%
Humbja e periudhës para tatimit	(5,225,054)	100%	(12,336,634)	100%
Humbja tatimore me shkallën tatimore standarde	(783,758)	15.00%	(1,850,495)	15.00%
<i>Rregullime për:</i>				
Të ardhura të patatueshme nga rimarrja e provizioneve për detyrime tatimore	(49,869)	0.95%	-	0.00%
<i>Shpenzime të panjohura:</i>				
Shpenzime për konsulencë ligjore	327,258	-6.26%	371,619	-3.01%
Shpenzime për konsulencë teknike	-	0.00%	392,755	-3.18%
Detyrime, gjoba dhe kamatëvonesa	6,000	-0.11%	587,636	-4.76%
Detyrime dhe gjoba në proces apeli tatimor	-	0.00%	48,369	-0.39%
Shpenzime përktimi	-	0.00%	7,176	-0.06%
Shpenzime postare	30	0.00%	83	0.00%
<b>TOTALI</b>	<b>(500,339)</b>	<b>9.58%</b>	<b>(442,856)</b>	<b>3.59%</b>

 14

# ANNA ENERGIA sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### (ii) E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë

Tabelat në vijim paraqesin llogaritjet në lidhje me tatimin e shtyrë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014. Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë aktivin tatimor të shtyrë pasi disponueshmëria e fitimeve të tatueshme për vitet vijuese nuk është e sigurt.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktive tatimore të shtyra	943,195	442,856
Detyrime tatimore të shtyra	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>943,195</b>	<b>442,856</b>

Lëvizjet në llogarinë e tatimit të shtyrë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Në fillim të periudhës</b>	442,856	-
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	500,339	442,856
<b>Në fund të periudhës</b>	<b>943,195</b>	<b>442,856</b>
Tatimi i shtyrë i panjohur	(943,195)	(442,856)
<b>Balanca e mbylljes</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra paraqiten si më poshtë:

	Humbje tatimore të mbartura	Totali
<b>Aktivi tatimor i shtyrë:</b>		
<b>Më 1 janar 2014</b>		
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	442,856	442,856
<b>Më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>442,856</b>	<b>442,856</b>
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	500,339	500,339
<b>Më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>943,195</b>	<b>943,195</b>

### 15. Transaksionet me palët e lidhura

Në datën e bilancit, shumat e mëposhtme u korrespondojnë ortakëve të Shoqërisë si dhe shoqërive të kontrolluara:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Të arkëtueshme nga palët e lidhura:</b>		
Paradhënie HEC Vluse sh.p.k.	304,107,157	288,003,945
<b>Detyrime ndaj palëve të lidhura:</b>		
Paradhënie nga ortakët për shpenzime operacionale	1,121,978	1,145,072
Parapagime nga ortakët	232,356,559	210,948,005

### 16. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

### 17. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

